

Shoqëria "Adriatica RC" Shpk

Datë më 24.10.2024

NUIS: M01506035F

Adresa: Rruga "Mustafa Matohiti", Pallati Gener 2, shkalla 2, kt.3, ap.8, Tiranë.

V E N D I M

**RENDI I DITËS:**

1. Transferimi i Kuotave në Shoqëri
2. Të ndryshme

**Të pranishëm në Mbledhje:**

- **Enkelejd Musabelliu**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.02.1987, lindur në Terovë, Skrapar, Shqipëri, i pajisur me letërnjoftimin me nr. personal I70205085E, zotërues i 1(një) kuote të barabartë me 100,000 (njëqind mijë) Lekë, dhe që përfaqëson 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë;

Të gjitha kërkesat për mbajtjen e një mbledhjeje të rregullt janë plotësuar në Përputhje me nenet e Statutit të Shoqërisë ("**Statuti**") dhe dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**").

**PËR SA MË SIPËR**, të gjithë anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme, të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë, **UNANIMISHT VENDOSËN**:

1. Të miratojnë transferimin e pjesëve të kapitalit të Shoqërisë tek Z. Enid Bala, lindur në Tiranë, me datë 29.12.1986, mbajtës i kartës së identitetit nr.personal I61229043M, në mënyrë të mëposhte:

Ortaku Enkelejd Musabelliu transferon tek Z. Enid Bala, 100% (njëqind për qind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë në vlerë 100,000 ALL (njëqind mijë Lekë) nga kuota që ai zotëron në Shoqëri;

2. Në përfundim të transaksioneve sa më sipër, struktura e Ortakëve të Shoqërisë bëhet si më poshtë:

Z. Enid Bala, do të zotërojë një (1) kuotë, që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë në vlerë 100,000 ALL (njëqind mijë Lekë);

3. Të autorizojë administratorin e Shoqërisë, të bëjë regjistrimet përkatëse pranë QKB.

Asnjë vendim tjetër nuk u mor tek Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

ORTAKU I VETËM

**Enkelejd Musabelliu**

*Enkelejd Musabelliu*

Rr. Mustafa Matohiti, pallati Gener 2, shk.2, kt.3, ap.8, Tiranë

[www.adriaticarc.com](http://www.adriaticarc.com)

**arc**  
Adriatica RC

## KONTRATË TRANSFERIMI

Sot, më 24.10.2024, palët e mëposhtme do të lidhin këtë Kontratë Transferimi ("**Kontrata**"):

(1) **Z. Enkelejd Musabelliu**, shtetas Shqiptar, lindur në Terovë, Skrapar, më 05.02.1987, mbajtës i Kartes ID nr. I70205085E; (këtu e më poshtë referuar si "**Shitësit**")

dhe

(2) **Enid Bala**, shtetas shqiptar, lindur më 29.12.1986, në Tiranë, Shqipëri, i pajisur me letërnjoftimin me nr. 024494515; (këtu e më poshtë referuar si "**Blerësi**")

Shitësit dhe Blerësi në vijim do të referohen individualisht si "**Palë**" dhe bashkërisht si "**Palët**".

### MEQËNËSE:

- Shitësi është pronar i ligjshëm i kapitalit aksionar të shoqërisë **Adriatica RC Sh.p.k.**, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 06.03.2020, me NIPT M01506035F, përfaqësuar nga Z. Enkelejd Musabelliu, në cilësinë e tij si Administrator i Shoqërisë ("**Shoqëria**").
- Shoqëria ka një kapital aksionar të regjistruar prej 100.000,00 ALL (njëqind mijë Lekë), i ndarë në 1 (një) kuotë ("**Kuotat**"). Kuotat e Shoqërisë zotërohen nga Ortakët sipas pjesëve të mëposhtme:
  - **Z. Enkelejd Musabelliu** është pronar i ligjshëm dhe përfitues i 1 pjesë, që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë me vlerë 100.000 ALL (njëqind mijë Lekë);
- Ortaku i vetëm i Shoqërisë do të transferojnë tek Blerësi 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë në vlerë 100,000 (njëqind mijë Lekë);
- Shitësi ka pranuar të shesë dhe Blerësi ka pranuar të blejë 100% të kapitalit të Shoqërisë.
- Në përmbushje të detyrimeve të tyre, Palët pranojnë të nënshkruajnë këtë Kontratë për transferimin e pronësisë mbi Kuotat nga Shitësit tek Blerësi dhe regjistrimin e Blerësit si pronari i ligjshëm i 100% (njëqind për qind) të Kuotave Shoqërisë pranë çdo dhe të gjithë autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë.

**PËR KËTO ARSYE**, në bazë të kushteve paraprahe të mësipërme, Palët pranojnë sa vijon:

1. Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Shitësi transferon Kuotat e Shitesit tek Blerësi dhe Blerësi blen dhe pranon Kuotat e Shitësit nga Shitësit, dhe si rrjedhim fiton titull të pronësie mbi 100% të Kuotave të Shitësit sipas kushteve të kësaj Kontrate.
2. Çmimi i blerjes për Kuotat në shitje do të jetë në një total prej 100.000,00 ALL (njëqind mijë Lekë) dhe Shitësi do të përfitojë 100.000,00 ALL (njëqind mijë Lekë) (**Çmimi i Blerjes**).
3. Në përfundim të transaksioneve sa më sipër, struktura e Ortakëve të Shoqërise bëhet si më poshtë:
  - **Z. Enid Bala**, do të zotërojë një (1) kuotë, që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë në vlerë 100,000 ALL (njëqind mijë Lekë);
4. Shitësi pranon që Blerësi të depozitojë këtë Kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Republikën e Shqipërisë, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe regjistrimin e ortakut të ri.
5. Shitësi pranon se do të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për të asistuar Blerësin në regjistrimin e titullit të tij të pronësisë mbi Kuotat.
6. Secila nga Palët e kësaj Kontrate i deklaron dhe i garanton Palës tjetër se i ka lexuar dhe i ka kuptuar plotësisht kushtet dhe dispozitat e kësaj Kontrate, se e ka rishikuar, këtë Kontratë me këshilltarin e saj ligjor dhe se e ka nënshkruar këtë Kontratë bazuar në gjykimin e kësaj Pale vetë dhe të këshilltarit të saj ligjor.

Kjo Kontratë është hartuar në gjuhën Shqipe në 4 (katër) kopje identike, një nga të cilat për Palët, një për regjistrat e Shoqërisë dhe një kopje për efekte të regjistrimit të ndryshimit të pronësisë në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Republikën e Shqipërisë.

**SHITESI:**

**Z. Enkelejd Musabelliu**

  


**BLERESI:**

**Z. Enid Bala**

